



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**

**V E N D I M**

**Nr. 7 Datë 16.04.2004**

**“PËR  
KRYERJEN E OPONENCËS TË STUDIMEVE TË REZERVAVE UJORE”**

Në mbështetje të nenit 6, pika b, të ligjit nr.8093,datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

**VENDOSI :**

1. Subjektet që kërkojnë të pajisen me leje për shfrytëzimin e materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve e përrenjve, si dhe me autorizime apo leje për shpime për ujëra nëntokësore, studimet e tyre duhet t'i paraqesin në Këshillat e Baseneve Ujëmbledhëse të shoqëruara me oponenca.
  - a. Instituti i Teknologjisë së Ndërtimit dhe Instituti i Teknologjisë së Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve të kryejnë oponencën e studimeve të subjekteve që aplikojnë për leje për shfrytëzimin e materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, përrenjve etj.
  - b. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të kryejë oponencën e studimeve të subjekteve që aplikojnë për marrje leje për shpimin e puseve për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore.
  - c. Tarifat për kryerjen e këtyre oponencave propozohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministri i Industrisë dhe Energjitikës dhe miratohen nga Ministri i Financave.

2. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI  
FATOS NANO